



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.Dh.Sh. II.nr. 1710/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit K.R.M.“Ekoregjioni”, SH.A., me NRB: 70465066, me seli në Prizren, rruga “Tahir Sinani”, nr.59, kundër debitorit Gj.D.. B.I. – DPT Megi Sony Playstation/B.Llapushnikut 8/2, Prizren, përfaqësuar sipas autorizimit nga D.N, avokat nga Prizreni, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2423/22 të datës 30.10.2023, me datë 05.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit K.R.M.“Ekoregjioni”, SH.A., ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2423/22 të datës 30.10.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2423/22 të datës 30.10.2023, në pikën I të dispozitivit të aktvendimit e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Gj.D.. B.I. – DPT Megi Sony Playstation/B.Llapushnikut, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.760/22 të datës 02.11.2022, i caktuar nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka shfuqizuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.760/22 i datës 02.11.2022, i caktuar nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkejeve esenciale të dispozitave të LPP-së, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe

për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2423/22 të datës 30.10.2023.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka kërkuar që të refuzohet ankesa e kreditorit si e pa bazuar ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2423/22 të datës 30.10.2023, të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori K.R.M.“Ekoregjioni”, SH.A., me dt. 02.11.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Kartelës së Konsumatorit me shifër ....., me të cilin ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj kreditorit tërësisht borxhin në shumë prej 1,046.39 €, si dhe të gjitha shpenzimet e përmbartimit, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit jo të drejtë të LMD-së. Ka theksuar se në bazë të nenit 360 par.1 pika 1.1, kërkesat për furnizimin e ujit, parashkruhen në afatin 1 vjeçar, nga e cila rrjedh se edhe propozimi i kreditorit është i përfshirë në parashkrim për periudhat deri në nëntor të vitit 2018. Me propozim që urdhri të ndryshohet dhe çështja përmbartimore të pushohet për shkak të parashkrimit si dhe të detyrohet kreditori që të shlyejë borxhin e parashkruar nga regjistrat e konsumatorëve, ndaj debitorit.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka deklaruar se i kundërshton në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim si të pabazuara për shkak se urdhri për përmbartim është lejuar në bazë të kartelës së klientit si dokument i besueshëm dhe çdo veprim është bërë duke iu referuar bazave

ligjore, përkatësisht nenit 29 par. 1.3 të LPP-së. Po ashtu sa i përket pretendimeve të debitorit për parashkrim, ka theksuar se borxhi i njëjtë nuk ka mundur të vjetërsohet pasi që debitori me nga një pagesë të vetme vjetore ka pranuar borxhin e që do të thotë se nuk kemi parashkrim të kërkesave. I ka propozuar gjykatës që të refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, dhe urdhrin për përmbnim P.nr. 760/22, të datës 02.11.2022, ta lë në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2423/22 të datës 30.10.2023, ku në pikën I të dispozitivit të aktvendimit e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Gj.D.. B.I. – DPT Megi Sony Playstatio/B.Llapushnikut, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbnimor P.nr.760/22 të datës 02.11.2022, i caktuar nga Përmbnuesi Privat Rushit Hoxha, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka shfuqizuar Urdhrin Përmbnimor P.nr.760/22 i datës 02.11.2022, i caktuar nga Përmbnuesi Privat Rushit Hoxha. Me arsyetim se gjykata ka vlerësuar se Kartela e Konsumatorit me nr....., në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbnim, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPPsë, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është kërkuar përmbnushja e borxhit nga debitorit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Shkallës së Dytë me shikim nga shkresat e lëndës ka vërejtur se borxhi në shumën prej 1,046.39€, është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me datën 30.09.2022 ndërsa në përmbajtjen e Kartelës Financiare të Konsumatorit, tek “Gjendja Fillestare” figuron shuma prej 499.64 €, mirëpo nuk është paraqitur periudha kohore për të cilën është krijuar ky borxh, përkatësisht nuk mund të vërtetohet se si ka ardhur deri te borxhi kryesor dhe si rrjedhojë ky dokument nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe nuk përmban atributet e një

dokumenti të besueshëm. Nagse se edhe me dispozitën ligjore të nenit 27 të LPP-së, në mënyrë shprehimore është përcaktuar se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Andaj në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim.

Andaj, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por të njëjtat i refuzoj si të pabazuara ngase nuk kishin me ndikim ndryshe në këtë çështje përmbarimore, andaj ankesën e kreditorit e refuzoj si të pabazuar dhe aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II nr.1710/23 me datë 05.04.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija- Ymeri